

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TechConsult”- SH.P.K

HYRJE

Sot në datën 27.04.2025 në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14/04/2008 “Për Tregëtarët, dhe Shoqëritë Tregëtare” i ndryshuar, ortaket e mëposhtëm, zotërues i 100% i kuotave të kapitalit të shoqërisë, me zotësi madhore :

1.Z.Kujtim Llupa, Shtetas Shqiptar i lindur në datë 15.03.1975, në Gurë i Bardhë dhe banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit të identifikimit me ID Nr.H50315249H.

2. Z.Marenglen Çoku, Shtetas Shqiptar,i lindur më 02.01.1983 në Elbasan dhe banues në Elbasan, Shqiperi, mbajtës i dokumentit të identifikimit me ID F70102169H

VENDOSIN SA MË POSHTË :

NENI 1

Formohet shoqëria “TechConsult -SH.P.K”. Shoqëria do të nenshtrohet legjislacionit Shqiptar , ndersa deget që mund të krijohen do të nenshtrohen legjislacionit ku do të ketë seline dega. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në baze të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaket themelues .

NENI 2

Shoqëria do të ketë seline e saj ligjore në adresën:

“Fshati Katund i Ri, Bradashesh, Nr.Pasurise 45/5(Njesi), ZK.2124, Elbasan”

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj , të hapë zyra përfaqësie ,dege, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë dhe/ose ortakut të vetëm.

NENI 3

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “TechConsult” - SH.P.K do të zhvillojë aktivitet me objekt:



1. Instalim, mirembajtje, monitorim te Mail Server (Windows/Linux), Instalim, mirembajtje, monitorim te Web Server (Windows/Linux), Instalim, mirembajtje, monitorim te rrjetit kompjuterik, Instalim, mirembajtje, monitorim te logeve per sigurine kibernetike. Tregti , instalim , mirembajtje te pajisjeve elektronike, elektrike etj brenda dhe jashte vendit. Shërbime konsulence ne fushen software dhe IT. Krijimin, implementim dhe zhvillimin te programeve softwareike. Tregtimin e produkteve software-ike dhe IT online. Aktivitete të komunikimit, Shërbime të përfaqësimit të mediave, Veprimtari marketingu dhe promocioni (edhe online) per te gjitha llojet e shërbimeve dhe mallrave perlllogari te vetat, ose ne funksion te te treteve: Konceptimi, organizimi dhe manaxhimi i reklamave te fushatave, eventeve, fushatave te marketingut, spoteve publicitare, ne fushen e design-it, publikimeve, reklamave dhe promocionit, etj. Përpunimi i të dhënave, aktivitete mbajtëse (hosting) të informacionit dhe aktivitete të lidhura me to, portat web. Lead Generation.

2. Ushtrimi i aktiviteteve ne fushen e teknologjise se informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe ne fushen e prodhimit/zhvillimit te softëare-ve. Operimi, menaxhimi, suporti i perdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik per sistemet softëare. Studimi i tregut dhe sondazhet.

Shërbime te adoptimit dhe pershtatjes se softwareve. Përmirësim/upgrade sistemesh informatike, Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software.

Instalim Rrjete dhe panele elektrike. Mirembajtje Rrjete dhe panele elektrik. Instalimin e mjeteve te sistemit te vezhgimit, audiovizive, instalimin shitjen dhe perdorimin e mjeteve te sistemit te radiokomunikimit, perdorimin shitjen dhe instalimin e mjeteve te akses kontrollit, , instalimin shitjen dhe perdorimin e paisjeve te rrjeteve .Monitorim i medialeve online, monitorim i shtypit te shkruar. Programe kompjuterike

3. Shoqeria mund te kryeje te gjitha aktivitetet e dobishme dhe/ose te nevojshme te lejuara nga legjislacioni ne fuqi, per realizimin e objektit te veprimtarise se shoqerise.

Objekti i veprimtarise te shoqerise mund te ndryshohet, perditsohet, plotesohet ne cdo moment me vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 4


Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pa përcaktuar. Ajo do të drejtohet nga Administratori Z. Kujtim Llupa. Shoqëria mund të prishet ose të pushojë aktivitetin e saj me një vendim të Asamblesë së Përgjithëshme të ortakëve, në bazë të lëgjisllacionit Shqiptar dhe statutit të shoqërisë.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Lekë (njëqind mije) leke i ndarë me 2 (dy) kuota.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:



1.Ortaku Z.Kujtim Llupa: Zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 50,000 (pesedhjetë mije) leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise;

2.Ortaku Z. Marenglen Çoku: Zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 50,000 (pesedhjetë mije) leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise;

NENI 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj . Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj .

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme.

NENI 7

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Krijimin e Shoqerive Tregtare” i ndryshuar, si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjom shoqeri .

NENI 8

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise “TechConsult” SH.P.K.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket.

O R T A K E T

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“TechConsult”- SH.P.K

Z.KUJTIM LLUPA

Kujtim Llupa


Z. MARENGLEN ÇOKU

Marenglen Çoku
